



## VENDIM

Nr. 320, datë 27.4.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 994, DATË 9.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, dhe të neneve 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Pika 6, e vendimit nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë vijon:

“6. Në çdo rast, kur është i nevojshëm hartimi i planvendosjes së ngastrave për regjistrim apo korigjimi dhe saktësimi i tyre, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 322, datë 27.4.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 669, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRCAKTIMIN, KRIJIMIN DHE REALIZIMIN E KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-2010), SI METADATË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në tekstin e vendimit e të rregullave bashkëlidhur tij, emërtimi “KRGJSH-2010” zëvendësohet me “KRGJSH”.

2. Në pikën 2, emërtimi “Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit” zëvendësohet me “Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike”.

3. Në tekstin e rregullave bashkëlidhur këtij vendimi bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nenin 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Në paragrafin e dytë, të pikës 3, fjalët “... “Epoka 2010”, lidhet me kohën (1 janar 2010), në të cilën duhet të llogariten koordinatat e rrjetit shtetëror GPS...”, hiqen.

ii) Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. CORS (Continuously Operating Reference Stations) është rrjeti i stacioneve referencë të operimit të vazhdueshëm për përcaktimin e pozicionimit tredimensional në sipërfaqen e tokës, nëpërmjet sistemeve GNSS.”.

b) Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Korniza Referuese Gjeodezike që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet “Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare” ose shkurt (KRGJSH).”.

ii) Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Përzgjedhja e realizimit të referencës evropiane dhe përcaktimi i epokës do të bëhen me vendim të ASIG-ut.”.

c) Neni 8 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 8

Rrjeti shtetëror GPS materializohet nëpërmjet ndërtimit të rrjetit shtetëror aktiv të stacioneve CORS dhe rrjetit shtetëror pasiv. Koordinatat e pikave të këtyre rrjeteve përcaktohen sipas KRGJSH-së.”.

ç) Pas nenit 8 shtohen nenet 8/1 e 8/2, me këtë përmbajtje: